



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 2509/12 Prot.

Koplik, më 26.12.2024

VENDIM

NR, 71 DATË 26 / 12 / 2024

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Fatmir Xhemal Haxhija, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Fatmir Xhemal Haxhija nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 6 datë 18.01.2024 "për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afat mesem 2024-2026 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Fatmir Xhemal Haxhija, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
2. Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2024 të miratuar me VKB. .06..date 18..01.2024 në programin "Perballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet në raste fatkeqesie".
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Fatmir Xhemal Haxhija, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vleren/shumen 500.000 (peseqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.6, datë, 18.01.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Malësi e Madhe " ,nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 03280".

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për familjen e z **Fatmir Xhemal Haxhija**, në vlerën e dëmit nga ana ndertimore në shumën **1,873,707**(një milion e teteqind e shtatedhjetë e tre mijë e shtateqind e shtatë) lekë, 50% i saj është **936.853**(Nenteqind e tridhjetë e gjashtë mijë e teteqind e pesëdhjetë e tre) leke dhe elektroshtëpija në shumën **236.900**(dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nenteqind) lekë, ku 50% i saj është **118.450** (Njeqindtetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) leke .sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe.Vlera totale e dëmeve është **2.110.607** Dymilion e njeqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e shtatë) leke ku 50% i saj është **1.055.304** (Një milion e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e katër)leke
5. Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **500.000** (peseqindë mijë) lekë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miruar me 26.12.2024

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 5

Zbardhur me datë 26.12.2024

